



ProCredit Bank

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË DYTË PUBLIK

Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi në Gjakovë, me datë 18.08.2020 ka nxjerrë konkluzionin P.nr.153/20, mbi shitjen e dytë publike të paluajtshmërisë së lënë hipotekë dhe atë:

Sipas fletës poseduese nr.i lëndës 01-142-20, ngastra kadastrale nr. P-71611071-00001-68 në sipërfaqe prej oborr 260 m² dhe shtëpi/ndërtesë 100 m², të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pejë, të evidentuara në emër të pronarit Arben Xhevat Dejolli.

Paluajtshmëria është e vlerësuar në shumë prej 118.080,00 Euro.
Paluajtshmëria e lartëcekur shitet me qëllim të realizimit-shlyerjes së obligimeve të debitorit Dph Al Forno përfaqësuar nga Arben Dejolli.

Në këtë seancë të ankandit të shitjes, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se 1/3 e vlerës së përcaktuar me konkluzionin për shitjen, duke u bazuar në dispozitat e nenit 234 të Ligjit Për Procedurën Përmbartimore.

Data e ankandit - shitjes: 08.09.2020, në ora 11:00h

Vendi i ankandit - shitjes: Zyra e Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi në Gjakovë, Rr."S.Stavileci" p.n

Të gjithë të interesuarit (ofertuesit) për blerjen e paluajtshmërisë duhet që më parë të deponojnë shumën e garancionit e cila duhet të jetë e barabartë me një të dhjetën e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, por nuk mund të jetë më e madhe se pesëmijë (5,000.00) Euro, me të drejtë të kthimit të kësaj shume ofertuesve, ofertat e të cilëve nuk janë pranuar.